



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK**

PROCES VERBAL PËR KËSHILLIM ME PUBLIKUN

PËR

“PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VKB NR.1, DATË 22.01.2025 “PËR TAKSAT DHE TARIFAT VENDORE NË BASHKINË SHKODËR”, I NDRYSHUAR.

Konsultim publik : I Hapur

Data : 06.11.2025

Ora : 13:00

Vendi: Salla e Këshillit bashkiak

Numri i pjesëmarrësve : *Numri i pjesëmarrësve 29, nga të cilët 19 gra,.*

Titulli i projekt-aktit që konsultohet: *“Për disa ndryshime dhe shtesa në VKB nr.1, datë 22.01.2025 “Për Taksat dhe Tarifat vendore në Bashkinë Shkodër”, i ndryshuar.*

Pjesëmarrës : Drejtues dhe specialistë të administratës së Bashkisë Shkodër dhe banorë (Bashkangjitur listë prezenca).

Takimi drejtohet nga Kryetari i Këshillit Bashkiak i cili bën një prezantim të shkurtër në lidhje me :

- ✦ Projekt-aktin e propozuar
- ✦ Shpjegoi qëllimin e konsultimit publik
- ✦ Shtroi pyetjet konkrete për pjesëmarrësit
- ✦ Dha informacion për mënyren e dhënies së rekomandimeve.
- ✦ Ju dha fjalën pjesëmarrësve

Pjesëmarrësit që morrën fjalën dhe diskutuan dhe dhanë rekomandimet përkatëse në lidhje me çështjen që konsultohet janë si vijon :

Fjalën e merr **Z.Bekim Mema**, drejtor i përgjithshëm i Drejtorisë së Zhvillimit të Qëndrueshëm Ekonomik, i cili bën një prezantim të detajuar të materialit të përgatitur nga administrata e Bashkisë Shkodër.

Banore, tek banesat sociale në Konviktin “Safet Spahiu”, merr fjalën dhe shpreh shqetësimin e saj lidhur me problemet që kanë aty, pasi ndajnë të njëjtin ambjent me shumë veta dhe shpesh ka edhe problem. Ato thjesht kërkojnë të bëhet ndarje me ambjentet e tjera të Konviktit.

Z.Luli sqaron se sot konsultimi publik po mbahet lidhur me dy propozime që lidhen me tarifat e kopshteve dhe çerdheve, si edhe me masat administrative që duhen mbajtur për shtëpitë funerale apo agjensitë funerale. Për jashtë kësaj, mendoj që mund të drejtoni një kërkesë dhe të merrni një përgjigje zyrtare për problemin tuaj.

Fjalën e merr **Z.Malevija**, i cili shprehet se paktikisht, ishte përgatitur për paketën e plotë fiskale, domethënë të buxhetit. Por në lidhje me pikën që po trajtoni, unë do donte një analizë se nga ku ka ardhur kjo rritje, sepse vëren që nga vjet, ajo rritet diku tek 600 lekë për çdo muaj për fëmijë. Cila është arsyeja? Ku ne ndërkojmë fëmijët, duhet të ndihmojmë. Pra, Bashkia nuk është keq me të ardhura dhe këtë e thoni edhe vetë, e tregoni edhe me shifra. Pse po rritet kjo tarifë, a ka një shpjegim?

Përgjigjet për këtë **Znj.Dama**, drejtoreshë e përgjithshme juridike në Bashkinë Shkodër duke sqaruar se që në krye të herës është bërë një analizë nga drejtori i arsimit, që në fakt lidhet me disa faktorë, përveçse rritjes së çmimeve të produkteve ushqimore. Prej shumë vitesh paketa fiskale për tarifën e kopshteve dhe çardheve nuk është ndryshuar dhe një motiv shumë i fortë është edhe menuja që ekzekutohet për kopshtet dhe për çerdhet. Nëse futeni në një analizë të thellë të çdo elementi të produkteve që përdoren për menunë ditore të kopshteve dhe të çerdheve është pothuajse e njëjtë. Por duke bërë një studim të thelluar, rezultoi që produktet për kopshte të njëjta, kurrësesi nuk mund të kenë çmime referencë të ndryshme për kopshte dhe çmime referencë të ndryshme për çerdhe. Kjo është konstatuar edhe gjatë periudhës që bëhet testimi i tregut dhe tenderimi i produkteve, të artikujve ushqimorë për kopshte dhe për çerdhe. Në vitin 2023 dhe në vijim është miratuar dhe është futur në funksion menuja e miratuar nga Ministria e Arsimit. Kjo ka sjellë pastaj edhe këtë analizë që Bashkia Shkodër ka qënë e detyruar ta bëjë.

Z.Luli kërkon që të sqarohet më tepër në lidhje me rritjen e tarifave nga sa ishte dhe sa bëhet. Pra më shumë në lidhje me propozimin në fjalë. Sa ishte vitin e kaluar dhe sa është propozimi për ndryshim?

Përsëri **Znj.Dama**: Atëherë, sipas VKB-së për miratimin e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Shkodër, tarifa për ushqim në kopshte është njëqind e gjashtëdhjetë lekë, ndërsa tarifa për ushqim në çerdhe është njëqind e njëzet e pesë. Të bazuar në urdhërin e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, nr. 76/1 datë 24.01.2018, "Për miratimin e ndryshimeve në menutë ushqimore të çerdheve dhe të kopshteve për fëmijët 0 deri në 6 vjeç", përcaktohet një menu ditore sipas grupmoshave përkatëse. Mbi bazën e këtij urdhëri, si dhe bazuar në çmimet përkatëse, sipas Instat-it, tarifa për ushqim në kopshte si kuotë ditore është 150, ndërsa në çerdhe është 125. Si rrjedhojë e rritjes së çmimeve të verifikuara kjo, dhe sipas të dhënave të Instat-it është i domosdoshme ky reflektim indeksi tek kuota ushqimore ditore e fëmijëve në kopshte dhe në çerdhe. Bazuar sa më sipër, kërkohet që në paketën fiskale të pasqyrohet ky ndryshim, ku tarifa në kopshte të bëhet 185 lekë, dhe tarifa në çerdhe të bëhet 155 lekë.

Z.Malevija: Po, por nga ana tjetër, si mund të jetë 500 lekë rritje për fëmijë? Duket një rritje e vogël por kjo rritje për shumë familje është e lartë. Menuja ka dalë që në 2018 dhe pse nuk është rritur me parë por tani?

Z.Luli : Jo, të lutem, vetëm në raport me tarifën që e përcakton paketa fiskale. Mos iu referoni tarifës mujore.

Përsëri Znj.Dama: Sa për një sqarim, është e vërtetë që menuja e re ka dalë në 2018, por siç e sqarova në Bashkinë Shkodër ekzekutohet menuja e re. Në 2023 ka qenë tenderi që bëmë me menunë e vjetër. Kemi qenë të detyruar të ekzekutojmë menunë e vjetër. Dhe përllogaritjet që janë miratuar në paketën fiskale janë sipas menuse, të cilën e ka konceptuar Bashkia Shkodër, sipas standardeve që Ministria e Arsimit përcakton për normat ditore të vlerave ushqyese që duhet të marrë një fëmijë. Tani jemi në në prag të miratimit të buxhetit prandaj është e nevojshme për Bashkinë Shkodër për të bërë një tenderim në kushte optimale në mënyrë që fëmijëve të ofrohen standardet e kërkuara ana e cilësisë ushqimore. Po ashtu është krejt evidente nga studimi që është bërë edhe me testimin e tregut, edhe nga statistikat zyrtare që janë në Instat sepse nuk është një studim i bërë vetëm në mënyrë të njëanshme nga Bashkia Shkodër. Jemi referuar statistikave zyrtare dhe normalisht nëse shikoni edhe tenderat e publikuar dhe ofertat fituese dhe të krahasoni çmimet me të cilën ofertohet produktet e artikujve ushqimorë, mund t'iu siguroj që asnjëri prej nesh nuk mund të blejë artikujt cilësorë ushqimorë që ne i japim fëmijëve me ato vlera. Është jologjike, sepse secili prej nesh e di që një kg mish në treg të lirë është dymbëdhjetë mijë lekë dhe një operator na e ofron me 6-8 mijë lekë. Bashkia Shkodër ka qëllimin e mirë që fëmijëve ti ofrojmë standarde në ushqim sepse është themeli i shoqërisë. Besoj se biem dakord se nuk mund të bëjmë kompromis në këtë pikë. Për sa i përket efektit financiar, besoj se jeni të informuar që Bashkia Shkodër tarifon me ditë frekuentimi dhe jo mujore dhe praktikisht Bashkia Shkodër për sqarim në këtë buxhet që do të miratojmë, ne duhet të miratojmë me frekuentim maksimal, pra ne duhet të ngurtësojmë ato lekë nga Bashkia Shkodër, pa llogaritur riskun e kthimit apo jo të plotë të investimit që bën Bashkia Shkodër sepse tenderat nuk presin fundin e vitit a erdhën apo s'erdhën aq fëmijë, por do të blehet ushqimi që t'i vihin në dispozicion. Kështu që për frekuentimin besoj është llogaritur diku tek 800 në total kopsht e çerdhe në vit. Besoj këtë mund të na e konfirmojnë edhe drejtoreshat, që për shërbimin me ushqim edhe kalohet ky numër fëmijësh, po sigurisht kompensohet nga mungesat e tjera dhe është e menaxhueshme. Kurse në lidhje me subvencionimin që zotnia me shumë të drejtë përmendi, dua të them se Bashkia Shkodër vitin që shkoj e ka rritur numrin e subvencionimit dhe pavarësisht kostos që me të drejtë zotëria përmend, shërbimi arsimor është publik dhe është falas. Pastaj zgjedhja për t'i çuar fëmijët në një kopsht me drekë është zgjedhja e prindëve, nuk është detyrim. Ky është një shërbim që Bashkia ofron karshi një pagese të caktuar, që nëse bëjmë një krahasim me të gjitha kopshtet edhe në rang të çdo qyteti në Shqipëri, nuk jemi me tarifën më të lartë. Dhe rritja e tarifave nuk është në nivelet që kapërcen nivelet e tarifimit për këtë lloj shërbimi me të ngjashmet e saj në Shqipëri.

Z.Luli pyet nëse dikush tjetër nga ana e të pranishmëve ka pyetje ose propozime që mund të merren në konsideratë, sepse siç thashë edhe në fillim, ky është një draft që propozohet, që për të arritur për miratim duhet të kalojë për vlerësim edhe nga ana e Komisioneve dhe pastaj të paraqitet në Këshillin Bashkiak.

Përsëri Z.Malevija shprehet se gjithsesi nuk duhet të rritet tarifimi...

Z.Luli: Po pra, është tarifë dhe tarifa ka koston e saj. Pra nuk është taksë, nuk është e ardhur për Bashkinë. Dhe kjo shkon në përmirësim të shërbimit.

Përsëri **Znj.Dama**, kam idenë që po flasim në një sens komplet të ndryshëm. Nuk bëhet fjalë për krijimin e të ardhurave për Bashkinë Shkodër. Domethënë, krijimi i të ardhurave përkthehet në shërbim dhe kjo është një kosto reale që i duhet Bashkisë Shkodër për të ofruar shërbimin, nuk bëhet fjalë që Bashkia Shkodër të krijojë të ardhura ose për të gjetur një mënyrë për të subvencionuar këto. Dhe nuk negociohet në asnjë moment nga Bashkia e Shkodrës standardi i shërbimit. Megjithatë, kostimi real i këtij shërbimi është sipas analizës që ka bërë drejtori i arsimit. Dhe po e përsëris, paketa fiskale ka vite që nuk është ndryshuar dhe me menunë aktuale që po ekzekutohet është e nevojshme të ndryshohet, sepse produktet që ofrohen për fëmijët nuk janë pesë produktet që kanë qenë deri para tre vjetëve, por aktualisht kemi 62 elementë të produkteve që marrin fëmijët e kopshteve në Bashkinë Shkodër, kemi menu dimri edhe vere, pra ju ndërshohet sipas stinëve. Dhe kemi menu të ndryshme me pesë vakte, çdo ditë të javës, plus tre vakte të ndërmjetme. Dhe besoj se është mëse i justifikueshëm shërbimi që ofrohet në raport me koston. Është e qartë që po kërkohet rritje për shkak të rritjes së çmimeve në treg, jo për shërbimin. Janë produktet që kushtojnë më shumë, rrjedhimisht edhe shërbimi na kushton më shumë. Çdo që është bazuar edhe nga politikat sociale që vetë Bashkia Shkodër ndjek.

Z.Luli: Pyetje e diskutime të tjera për këtë pikë nuk ka, prandaj kalojmë tek pika tjetër që lidhet me masat administrative përsa i përket agjensive, funerale dhe shtëpive të pritjes.

Z.Mema përsëri relaton sipas materialit të prezantuar nga administrata e Bashkisë Shkodër.

Z.Malevija shprehet në lidhje me këto gjopa.... Atëherë me sa u tha nuk paskan qenë të bazuara në ligj...

Z.Mema Jo, absolutisht që ato gjobat që janë vendosur, me patjetër që e kanë pasur bazën ligjore, edhe janë bazuar në paketën fiskale. Për ushtrim të aktivitetit jashtë hapësirave të dedikuara apo jashtë rregullave të cilat kanë qenë të miratuara në paketën fiskale. Sot ne po e specifikojmë dhe po e kontrollojmë më së miri vendosjen e këtyre ghobave për agjensitë funerale në mënyrë që edhe kontrolli edhe monitorimi i rregullores të jetë sa më specifik dhe mos të vendosim ushtrim të aktivitetit në hapësirë publike të pamiruar. Siç është e miratuar në paketën fiskale, ajo gjobë, do të jetë gjobë specifike që shkon drejt rregullimit të aktivitetit të ushtrimit të aktivitetit të shtëpive funerale. Theksoj që është fakt që i gjithë propozimi dhe relacioni është i bazuar në ligj, në udhëzime, në VKM-të përkatëse që i japin të drejtën Bashkisë që përgjatë monitorimit dhe kontrollit të territorit dhe të aktiviteteve të ndryshme, të vendosin gjoba dhe masa administrative, po të jetë një çështje bazuar në ligj për të sistemuar funksionimin e këtij sektori, të ketë edhe masat administrative sa më specifike dhe të detajuara.

Znj.Donika Ndoja, administratore e rajonit nr.5 merr fjalën duke thënë se ajo vetë ka qenë pjesë e grupit të punës që është marrë me çështjen në fjalë. Ajo propozon që përveç kritereve që janë miratuar edhe nga vetë Këshilli Bashkiak, duhet që licenca e ofrimit të shërbimit të këtyre agjensive ose shërbimeve funerale të jetë me një afat pesëvjeçar nga operatorët.

Z.Saimir Rrustemi, drejtor i Policisë Bashkiake shton se beson se Z.Mema e ka bërë të qartë, se po flasim për të vendosur masë ndërrshkimore për ata që nuk i binden urdhërit për mbylljen e këtyre hapësirave, e këtyre aktiviteteve, të këtyre agjensive. Besoj se duhet të mirëkuptohemi që

kjo është e vetmja armë që keni ne për të kontrolluar që të jemi të barabartë në treg me të gjithë operatorët që operojnë në këtë drejtim.

Pyetje dhe diskutime të tjera nga të pranishmit nuk ka . Dëgjesa për “Për disa ndryshime dhe shtesa në VKB nr.1, datë 22.01.2025 “Për Taksat dhe Tarifat vendore në Bashkinë Shkodër ”, i ndryshuar. deklarohet e mbyllur.

SEKRETARE

Sabina Danaj

Zbardhi procesverbalin:

Bekim Mema



Irma Sulishti





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK

LISTË PREZENÇË

KONSULTIM PUBLIK: Për disa ndryshime dhe shtesa në VKB nr.1, datë 22.01.2025 "Për Taksat dhe Tarifat vendore në Bashkinë Shkodër", i ndryshuar.

Date: 06.11.2025

NR.	EMRI MBIEMRI	LAGJA/ESHATI	KONTAKT (tel)	e-mail	FIRMA
1	Besmi Hoxhalli	Lagje 1	0682404375		
2	Maher Jallaci	Lagje 4	0676003026		
3	Bubur Boshçi	Lagje 2	0689224549		
4	Anton Bede	Lagje 3	0685324024		
5	Blerina Dibra	Perfaqësuesi Qarkor	0682408108		
6	Shmiramida Dajmaleri	Perfaqësuesi Qarkor	068349976		
7	Ejvi Rripai	Drejtoria 8	0674086246		
8	Anila Barbullush	Drejtoria 10	0674060881		

NR.	EMRI MBIEMRI	LAGJA/ESHATI	KONTAKT (tel)	e-mail	FIRMA
9.	ARIONE Nikoll	Drejtoria 09	06992057656	ariona.78@hotmail.com	
10.	ARJETA XHAFFERI	Drejtoria 5	0674060356	arjeta.xhaferi@yahoo.com	
11	Arila Nallaku	J. Vllahodit	myriadi@balkanbalkan.com	Arila Nallaku	
12	Janiza Dacol	Jholleza nr 4	0676064320	dacola.daniza@gmail.com	
13	Ariola Dristiti	Drejtoria nr 6	0674060364	dristitariola@gmail.com	
14	Shkërite Sineu	Drejtoria nr 11	0682205605	shkrite.sineu@hotmail.com	
15	Arijana Baci	Drejtoria Nr 8	0674068322	arijanabaci@yahoo.com	
16	Arieta Anamali	Drejtoria nr 13	0699166646	arieteanamali@gmail.com	
17	Arbërie Rethiku	Drejtoria nr 7	0685217430	arbërie.dauhi@hotmail.com	
18	Arilda Hoxha	Kongjiti Rr. 5	0699230909		
19.	Belena Feyta	Nelja Renda. Rr. 14	0692244080		
20.	Renato Dumsci	Bashkia Shkoder	0694796999	renato.lumci@bashkia.shkoder.gov.al	
21	Shkupur Dhalugo	Enver Haxhi	0692729460	shkupurdhalugo@yahoo.com	
22	Deaika Udoja	Llogji Nr 5	0688803188	deaidka.udoja@gmail.com	
23	Enduro Degeri	Drejtoria 5	0682053123	enduro.degeri@gmail.com	
24	Nerida Halili	Majlinda Gjokaj	0673570001	neridahalili@gmail.com	
25	Stela Shkurisja	13 Shkoder	0683400073	stela.shkurisja@gmail.com	
26	Shaim Procinu	8 Shkoder	0692020144		
27	Himela Soda	8 Shkoder	0693505412	himelaso@bashkia.shkoder.gov.al	
28	Rele Naturody	8 Shkoder	0682473040	rele.naturody@yahoo.com	

[illegible]